

**Fëmijët migrantë pa
dokumente kanë të
drejtën të shkojnë në
shkollë!**

Të gjithë fëmijët në Suedi nga moshën 6-18 vjeç kanë të drejtën të ndjekin edukimin, përfshi këtu gjithë fëmijët migrantë pa dokumente. Kjo aplikohet për parashkollorët, shkollën parësore, sekondare dhe edukimin e veçantë dhe transportin për në shkollë.

Një shkollë për të gjithë fëmijët!

Përshëndetje!

A e dinit se që nga 1 korriku 2013, fëmijët migrantë pa dokumente në Suedi, sipas ligjit kanë të njëjtat të drejta për edukim sikurse fëmijët e tjerë? Kjo do të thotë se fëmijët kanë të drejtën të:

- Të ndjekin klasën parashkollore - Vitin kur fëmija mbush 6 vjeç, ai ose ajo mund të fillojnë aktivitetet e gjashtë vjetëve. Kjo i përgatit fëmijët për shkollën fillore. Librat dhe dreka janë falas.
- Të ndjekin shkollën parësore – Kur fëmija mbush 7 vjeç, ai ose ajo fillojnë shkollën fillore. Fëmija merr libra dhe drekë falas. Shkolla parësore është nëntë vjet.
- Shkolla e nivelit të dytë – Të rinjtë që kanë mbaruar shkollën parësore mund të zgjedhin të shkojnë në shkollën e nivelit të dytë. Ka programe të ndryshme të shkollave të nivelit të dytë ku mund të aplikohet dhe shpesh ato janë 3 vjeçarë. Nëse ju, si migrant pa dokumente, filloni shkollën e nivelit të dytë përpara se të mbushni 18 vjeç, keni të drejtën ta përfundoni edukimin tuaj edhe pas moshës 18 vjeç.
- Edukimi i veçantë – Edukimi i veçantë është një shkollë ku fëmijët dhe të rinjtë me paaftësi mendore mund të marrin një edukim të përshtatur.
- Nëse është e nevojshme ka në dispozicion transport për vajtur dhe për t'u kthyer nga shkolla. Ju keni të drejtën të deklaroni një adresë ku mund të merreni, nëse nga frika nuk dëshironi të jepni informacionin e adresës aktuale.

Duhet të dini edhe se shkolla në Suedi është falas.

Çfarë duhet të bëj në mënyrë që

fëmija im të shkollë në shkollë?

Lutemi kontaktoni shkollën ku dëshironi të shkojë fëmija juaj. Kur t'i kontaktoni, thuajuni se keni një fëmijë që doni ta çoni në shkollë dhe se dëshironi të flisni me drejtorin(eshën). Duhet të dini se shkolla është e pavarur nga autoritetet e tilla si Bordi i Migracionit dhe Policia. Ju keni të drejtën të mbeteni anonim kur kontaktoni personelin në shkollën e fëmijës tuaj. Jepni vetëm informacionin që dëshironi.

Gjërat që duhen patur parasysh për

personelin e shkollës:

Informacioni i kontaktit: Për shkak se shumë migrantë pa dokumente shpesh nuk kanë adresë fikse, mënyra më e thjeshtë për të kontaktuar fëmijën ose prindërit është nëpërmjet telefonit.

Id: Disa mugrantë pa dokumente nuk kanë dokumente identifikimi.

Privatësia dhe siguria: Për të ofruar siguri për fëmijët dhe të rriturit migrantë pa dokumente, është e rëndësishme që të mbahen sekrete situata dhe identiteti i migrantit pa dokumente. Vetëm atyre që ju duhet pa tjetër ta dinë mund t'u thuhet kjo gjë.

Të drejta të barabarta në edukim

sipas ligjit

(Ligji i lejon fëmijët migrantë pa dokumente të kenë të drejtën e edukimit)

Që nga data 1 korrik 2013, të gjithë fëmijët në Suedi kanë të drejtën e barabartë të edukohen. Kjo bëhen sipas një ndryshimi (Ligji 2012.13: 58) në Ligjin për Edukimin (2010:800), i cili do të thotë se fëmijëve që janë në këtë shtet pa autorizim do t'u jepen të njëjtat të drejta për t'u edukuar në një parashkollë, shkollë parësore dhe lloje ekuivalente të shkollave dhe shkolla të nivelit të dytë dhe shkolla të specializuara, sikurse dhe fëmijët që jetojnë në këtë shtet. Këta fëmijë do të kenë të drejtën edhe që të përdorin transportin e shkollës.

Keni ndonjë pyetje?

Kontakttoni vendin e takimit të Kryqit të Kuq për migrantët pa dokumentet në:

E-maili:

motesplats@redcross.se

Ky informacion gjendet edhe në anglisht.

Ky informacion gjendet edhe në arabisht.

Ky informacion gjendet edhe në mongolisht.

Ky informacion gjendet edhe në persianisht.

Ky informacion gjendet edhe në rusisht.

Ky informacion gjendet edhe në spanjisht.

Ky informacion gjendet edhe në serbo-kroatisht.

Ky informacion gjendet edhe në shqip.